



UNMIK/URDH/2001/25
24 dhjetor 2001

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2001/25

**ZBATIMI I RREGULLORES SË NDRYSHUAR TË UNMIK-ut NR.
1999/3 PËR THEMELIMIN E DOGANËS DHE SHËRBIMEVE TË
TJERA PËRKATËSE NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 6 të Rregullores së ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë nr. 1999/3 të datës 31 gusht 1999 për Themelimin e doganës dhe shërbimeve të tjera përkatëse në Kosovë,

Me qëllim të specifikimit të doganës së brendshme në pajtim me nenin 5 të Rregullores së UNMI-ut nr. 1999/3 ku do të bëhet kontrolli doganor dhe zhdoganimi përfundimtar,

Me anë të kësaj shpall këtë Urdhëresë administrative;

Neni 1
Përkufizimet

Sipas kësaj Urdhërese administrative:

“Kontroll doganor” nënkupton masat e aplikuara nga Shërbimi Doganor i UNMIK-ut për sigurimin e respektimit të ligjeve doganore në fuqi ose, sipas nevojës, për sigurimin e respektimit të dispozitave të tjera që vlejné për mallrat të cilat i nënshtrohen kontrollit doganor, duke përfshirë veçmas verifikimin e ekzistimit dhe autenticitetin e dokumenteve, kontrollin e llogarive dhe shënimeve të tjera të veprimeve afariste, kontrollimin e mjeteve të transportit të personave dhe mallrave, inspektimin e bagazhit dhe mallrave të tjera që barten me ose pa njerëz, por duke mos u kufizuar vetëm në kontrollin e mallrave.

“Zhdoganim doganor” nënkupton formalitetet e doganës dhe formalitetet e tjera të nevojshme për të lejuar hyrjen e mallrave në territorin e Kosovës që duhet të eksportohen apo vendosen nën një procedurë tjetër doganore në përputhje me ligjin në fuqi dhe ngarkimin e çfarëdo tatimi apo takse të duhur ligjore.

Neni 2
Specifikimi i doganave të brendshme

2.1 Deri te një njoftim tjetër Dogana e UNMIK-ut në Prishtinë do të caktohet si një depo e brendshme doganimi/zhdoganimi, ku do të bëhet kontrolli doganor dhe zhdoganimi.

2.2 Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut, në konsultim me Autoritetin Qendror Fiskal, do të përcaktojë orarin e punës së Depos së UNMIK-ut për doganim/zhdoganim, siç është përcaktuar në nenin 2.1 më lart me anë të një urdhërese administrative.

Neni 3
Rregullime administrative

Kjo Urdhëresë administrative do të zbatohet nën mbikëqyrjen e autoritetit të përgjithshëm të UNMIK-ut nga doganierët, zyrtarët tatimorë, policia dhe forcat e sigurimit dhe çdo autoritet tjetër i caktuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresa administrative hyn në fuqi më 24 dhjetor 2001.

Hans Haekkerup,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm